



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 171, paragrafi (3) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për llojin, mënyrën e dorëzimit dhe përmbajtjen e raporteve të transaksioneve pagesore ndërkufitare të njëhershme, në bazë të remitancave

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet lloji, mënyra e dorëzimit dhe përmbajtja e raporteve të transaksioneve pagesore ndërkufitare të njëhershme, në bazë të remitancave që institucionet pagesore, përkatësisht institucionet e parasë elektronike, i dorëzojnë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

2. Për qëllime të këtij vendimi, institucioni nënkupton institucionin pagesor dhe institucionin e parasë elektronike.

II. LLOJET E RAPORTEVE DHE MËNYRA E DORËZIMIT

3. Institucioni që kryen transaksione ndërkufitare të njëhershme pagesore në bazë të transfertave të parave, është i obliguar që të përgatisë dhe të dorëzojë raporte mujore në Bankën Popullore për transaksionet pagesore individuale, duke përfshirë të dhënat për transfertat e parave të bëra nëpërmjet agjentëve me të cilët ka lidhur marrëveshje.

Afati për dorëzimin e raporteve nga paragrafi (1) i kësaj pike, është pesë ditë pune nga fundi i muajit për të cilin është dorëzuar raporti.

4. Raportet nga paragrafi (1) i pikës 3) të këtij vendimi, i dorëzohen Bankës Popullore në mënyrë elektronike, në pajtim me aktin nënligjor që rregullon lidhjen me sistemin informativ të Bankës Popullore.

Institucioni është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe informacioneve të dorëzuara në Bankën Popullore dhe është i detyruar të vendos rregulla dhe procedura të qarta për sigurimin e saktësisë së të dhënave dhe informacioneve të dorëzuara, duke përfshirë fshirjen ose korrigjimin në kohë të të dhënave të pasakta ose jo të plota.

Nëse klienti, person fizik, paraqet kërkesë me shkrim pranë institucionit për fshirjen ose korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota, me dëshmi përkatëse, institucioni është i detyruar të fshijë ose korrigjojë të dhënat e pasakta ose të paplota brenda afatit të përcaktuar me ligj dhe të dorëzojë një raport të ri në Bankën Popullore.

III. PËRMBAJTJA E RAPORTEVE

5. Raportet mujore nga pika 3) e këtij vendimi, institucioni dorëzon në formularin 1 – RTPNN – Raport i transaksioneve pagesore ndërkufitare të njëhershme në bazë të remitancave, të dhëna në shtojcën 1 të këtij vendimi së bashku me pozicionet/fushat që duhen plotësuar.

6. Institucioni është i detyruar që raportin e parë të vitit 2023 ta dorëzojë në Bankën Popullore me gjendjen e 31 janarit 2023.

IV. DISPOZITAT E PËRFUNDIMTARE

7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/XXII-5/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

SHTOJCA 1**Formulari 1 – RTPNN– Raporti i transaksioneve pagesore ndërkufitare të njëhershme në bazë të remitancave**

1) Numri i amzës i institucionit:		2) Emri i institucionit dhe numri i telefonit të kontaktit			3) Numri i amzës dhe emri i agjentit:		
Të dhënat e transaksioneve të veçanta							
4. Shifra e vendit	5. Data e transaksionit	6. Emri dhe mbiemri i klientit (dërguesit/marrësit)	7. NVAQ ose numri i pasaportës	8. Shifra e banorit/jorezidentit	9. Shifra e valutës	10. Shuma e arkëtimit (në valutë)	11. Shuma e pagesës (në valutë)
1	2	3	4	5	6	7	8
Gjithsej sipas valutave:							

Raporti përgatitet për muajin raportues në valutën origjinale, gjatë së cilës shënohen të dhënat e mëposhtme:

- Numri i amzës i institucionit;
- Emri i institucionit dhe numri i telefonit të kontaktit;
- Numri i amzës dhe emri i agjentit (nuk plotësohet nëse institucioni raporton për transaksionet personale).

Për transaksionet e njëhershme, plotësohen të dhënat e mëposhtme:

- Shifra e vendit (nga libri i shifrave të shteteve sipas aktit me të cilin rregullohen transaksionet pagesore me shtetet e huaja të miratuar nga guvernatori i Bankës Popullore);
- Data e transaksionit/realizimit të shërbimit (arkëtimi, respektivisht pagesa);
- Emri dhe mbiemri i klientit (dërguesit/marrësit)
- NVAQ ose numri i pasaportës (NVAQ të shtetasit në rastin e personit fizik vendas - rezident, respektivisht numri i dokumentit të identifikimit në rastin e personit fizik të huaj - jorezident);
- Shifra e banorit/jorezidentit;
- Shifra e valutës (nga libri i shifrave të valutave sipas aktit që rregullon realizimin e pagesave të jashtme të miratuar nga guvernatori i Bankës Popullore);
- Shuma e arkëtimit (në valutë), dhe
- Shuma e pagesës (në valutë)